

## AKT THEMELUES

I  
SHOQERISE NDERTUESE, PRODHUESE E TREGTARE PRIVATE  
"BOROVAÐ" SH.P.K.

### DURRES

1. SAIMIR MALI, i biri i ISMAILIT, datelindja 5 prill 1964,  
lindur ne BOROVE, DIBER e banues ne DURRES  
LAGJA 14.

### NENI 1

Te krijojne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar ndertimore,  
prodhuese e tregtare me emertimin " BOROVAÐ(SHPK) .

Shoqeria do t'i nenshtrohet legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij  
akti themelimi dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga  
ortaku i vetem themelues i saj.

Deget e shoqerise do te veprojne per llogari te kesaj shoqate  
dhe brenda kompetencave qe shoqeria do t'i jape atyre.

### NENI 2

Selia e shoqerise me perggjegesi te kufizuar " BOROVAÐ" (SHPK)  
do te jete ne Durres ne adresen lagja 14, ish Ndermarrja  
industriale .

Shoqeria do te krijoje dege dhe filiale, perfaqesi dhe agjensi  
ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise, si dhe jasht  
vendit.

### NENI 3

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine ne fushat:

1. Ndertim, montim, restaurim objektesh , punime dheu,  
murature, betoni, beton armeje, punime shembjesh, ndertime  
industriale, civile, turistike, buqesore etj. dhe kompletimin me  
instalimet e nevojshme per to. Ujesjellsa, kanalizime, si dhe  
prodhim e tregetim te materjaleve te ndryshme te ndertimit.

### NENI 4

Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria do te hape njesi  
tregtuese, perpunuese dhe sherbimi dhe do te bashkepunoje me  
persona fizike dhe juridike vendas dhe te huaj.

Me miratim te ortakeve, shoqeria mund te pranoje si ortake ne  
(shif statutin) firme edhe persona te tjere, duke pranuar kapitalin  
e tyre ne te holla apo sipas mareveshjes.

NENI 5

Shoqeria ndertimore, prodhuese e tregtare " BOROVAD(SHPK) " do te kete nje kohezgjatje te veprimtarise se saj mbi 10 vjet dhe mund te shperbehet ( SIPAS STATUTIT) ne cdo kohe dhe per cfardo shkaku.

Asamblea e ortakeve vendos per menyren e likujdimit dhe cakton nje ose me shume likuidatore.

NENI 6

Kapitali fillestar i shoqerise tregtare private " BOROVAD" do te jete 100 mijë leke dhe do te perbehet nga kuota ortakut te vetem themelues.

Kapitali fillestar mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit qe do te marri ortaku i vetem.

NENI 7

Ortaku e shoqerise ndertimore, prodhuese e tregtare " BOROVAD" ka te drejta dhe detyrime sipas legjislatacionit ne fuqi.

NENI 8

Ortaku i vetem duhet te beje perpjekje per rritjen e potentialit ekonomik te shoqerise, te ruajne sekretin e saj, te mos demtojne interesat e shoqerise dhe te ortakve te tjere.

NENI 9

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj, ortaku i vetem Saimir Mali.

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte i shoqerise me perjegjesi te kufizuar "BOROVAD"(SHPK) .

NENI 10

Te ardhurat neto i takojne ortakut te vetem themelues te shoqerise" BOROVAD"(SHPK)

NENI 11

Mosmareveshjet qe mund te lindin me te tretet gjate zbatimit te ketij akti themelimi , ne rast se nuk do te zgjidhen me mirkuptim, do te zgjidhen nga organi kompetent, sipas ligjeve ne fuqi.

NENI 12

Ky akt thmelimi mund te ndryshohet ose te plotesohet me me vendim te ortakut te vetem themelues te shoqerise.



- 3 -

NENI 13

Statuti i kesaj shoqerie eshte pjesa perberese e ketij akti themelimi

NENI 14

Ky akt themelimi do te hyje ne fuqi pas marrjes se vendimit nga Gjykata e Rrethit Tirane.

Ky akt themelimi u perpilua ne kater kopje dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

Akti themelimit nenshkruhet rregullisht me vullnetin e tij te lire prej ortakut te vetem.

O R T A K U I V E T E M

Saimir Mali

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E DREJTESISE  
ZYRA E NOTERISE DURRES

Nr. 7 Rep

Nr. 7 Kol

V E R T E T I M

Sot me daten 11.1 1996 (nentedhjet e gjashte) u paraqit personalisht Z. Saimir Mali, me gjineralitet e sipershenuara, per iidentitetin e te cilit e verifikova nepermjet leternjoftimit te tij personal, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili deklaroi se ka redaktuar jasht kesaj zyre kete kerkeze, me vullnetin e tij te lire, ai e nenshkruan rregullisht para meje dhe une Noteri e vertetoj sipas ligjit.

N O T E R I

*H. SAIH T. TAYALLI*





**S T A T U T I**  
**SHOQERISE ME PERGJGJESI TE KUFIZUAR " BOROVAD"**

Ne mbeshtetje te ligjit Nr 7512 date 10.8.1991 si dhe te ligjit Nr 7630 date 19.1.1992, une i quajturi SAIMIR MALI, ortak i vetem si themelues i shoqerise tregtare " BOROVAD" SHPK , me zotesi te plote juridike per te vepruar, sot me daten 18.12.1995 shpalla:

Formimin e Shoqerise me Pergjgjesi te Kufizuar (ortak i vetem)

Neni 1

Formohet shoqeria tregtare private me ortak te vetem e emeruar "BOROVAD" me themelues zoterine: SAIMIR MALI i biri ISMAILIT, datelindja 1964, lindur ne BOROVE, DIBER, banues ne adresen LAGJA 14 DURRES.

SELIA e shoqerise do te jete ne adresen LAGJA 14 DURRES, prane ish PARKU INDUSTRISE. .

ADMINISTRATOR Ortaku i vetem SAIMIR MALI

FORMA E SHOQERISE

Neni 2

Shoqeria ndertimore, prodhuese e tregtare " BOROVAD" eshte shoqeri me pergjergjesi te kufizuar (SHPK) dhe perballon humbjet deri ne kufirin e vleres se kountributit te ortakut te vetem ne kapitalin themelues.

SELIA E SHOQERISE

Neni 3

Shoqeria do te kete si vengendrim legal te saj ne Durres, ne Lagjen 14. Shoqeria mund te hape vendqendrime te tjera te dyta operative, filiale, perfaqesi dhe agjensi ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise si dhe jasht vendit.

KOHEZGJATJA

Neni 4

Shoqeria do te kete nje kohezgjatje te veprimtarise se saje mbi 10 vjet.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 5

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj: ne fushen e ndertim montim, restaurim objektesh, punime dheu, murature, betoni, beton armeje, punime shembjesh, ndertime industriale, civile, turistike, bujqesore etj, Ujesjellsa, kanalizimi etj.



Prodhim e tregtim te materjaleve te ndryshme te ndertimit. Eksport import te artikujve industriale, ushqimore, makineri e paisje, materjale te ndertimit etj. Veprimtari ne fushen e transportit, per transport mallrash e pasagjeresh.

### KAPITALI I SHOQERISE

Neni 6

Kapitali i shoqerise "BOROVA'D"do te jete 100 mijë leke dhe perbehet nga kuotat e ortakut te vetem themelues.

Kapitali fillestar i shoqerise mund te ndryshohet simbas vendimit qe nund te marrin ortaku i vetem themelues.

### ORGANET DREJTUESE

Neni 7

Organet drejtuese te shoqerise do te jene:"

Asambleja, detyre te cilen e kryen ortaku i vetem.

Administrator i shoqerise do te jete ortaku i vetem.

Ortaku i vetem ka te drejte qe sipas ligjit ne fuqi te emeroje

per nje periudhe kohe tre vjecare nje administrator, ose disa per drejtimin e shoqerse.

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e punes e organit drejtues rregullohet ne Statutin e shoqerise dhe legjislacionit ne fuqi.

### DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 8

Shoqeria "BOROVA'D" deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky statut, aktit themelues dhe legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Shoqeria fiton zotesine e saj per te vepruar me rregjistrimin e saj ne Gjykaten e Tiranes dhe ushtron veprimtarine e saj ekonomike me rregjistrimin ne organin perkates tatumor.

Neni 9

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtje SH.P.K "BOROVA'D"

Neni 10

### ASAMBLEJA ORTAKEVE

Kompetencat e Asamblese, perderisa SH.P.K. "BOROVA'D" ngelet ortak i vetem, i merr administratori, qe eshte ortaku i vetem.

Neni 11

Administratori eshte i veshur me fuqi per drejtimin e zakonshem dhe te jashtzakoneshem te shoqerise pa asnje kufizim. Ai eshte i autorizuar te kryeje te gjitha veprimet qe konsiderojne te

-3-

pershtatshme per arritjen e qellimeve te shoqerise. Ai ka te drejte midis te tjerash te bleje, te shesi, te kembeje pasuri, te lidhen e te bashkepunojne me shoqeri te tjera qe jane ngritur apo do te ngrihen brenda e jasht vendit, duke siguruar pjesmarrje per qellimet e veprimtarise se shoqerise te parshikuara ne statutin dhe aktin themelues te shoqerise. Ai kryen te gjitha veprimet ne emer dhe per llogari te firmes, prane te gjitha zyrave shteterore e private, me cdo person juridik apo fizik, veprime juridike prane gjykatave apo zyrave te ipoketes e noterise. Kryen prane institucioneve bankare financiare veprime depozitimi, kreditimi, pagesa dhe arketime si dhe veprime te tjera.

#### Neni 12

Administratori i shoqerise cakton detyrat dhe pagat per punonjesit e punesuar ne shoqeri.

Shoqeria merr persiper te zbatoje dispozitat e Kodit te Punes te Republikes se Shqiperise dhe ligjin per Sigurimet shoqerore.

#### MAREDHENIET E PUNES

##### Neni 13

Maredheinet e punes ne shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk rregullohen ne kontraten e punes zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Mosmareveshjet e punonjesve dhe shoqerise do te zgjidhen nga Gjykata e rrethit. Punonjesit e emeruar nuk marrin pjese ne ndarjet e fitimit te realizuar nga shoqeria gjate ushtrimit te veprimtarise se saj.

Per punen e kryer punonjesit marrin pagen sic eshte parashikuar ne kontraten e punes.

#### BILANCI DHE TE ARDHURAT

##### Neni 14

Veprimet ekonomike dhe financiare te shoqerise do te mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti.

Ne fund te cdo periudhe nxirret bilanci kontabel ne fitime, humbje etj. simbas ligjeve ne fuqi.

Bilanci kontabel miratohet nga ~~Ortaku i vetem~~ i shoqerise.

Me miratimin e bilancit kontabel ~~ortaku i vetem~~ vendos per krijimin e fondeve te ndryshme te nevojshme si fondin e akumulimit, fondin rezevre etj.

##### Neni 15

Te ardhurat neto pas vecimit te fondeve te permeduara me siper dhe pagimit te detyrimit fiskal, pagat e punonjesve, i mbesin ne perdonim ortakut te vetem te shoqerise.

Fitimi i realizuar nga shoqeria i mbetetet ortakut te vetem.

#### SHPERBERJA E SHOQERISE

Neni 16

Shperberja e shoqerise mund te behet ne rastet e parashikjuara ne Ligjin " Per shoqerite tregtare". Ne keto raste ortaku i vetem e shoqerise vendos mbi menyren e likujdimit.

Likuidatori eshte perjegjes per ruajtjen e pasurise, perderisa t'u aorezohet personave perkates fizike e juridike, duke likujduar ne rradhe te pare detyrimet ndaj personave te trete qe ka shoqeria.

Ne se fondet disponibel rezultojne te pamjaftueshne per shlyerjet e detyrimeve te shoqerise, ortaku i vetem i shoqerise duhet te derdhi kuotat e nevojshme per kete qellim.

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Neni 17

Persa nuk eshte shprehur teresisht ne kete statut i referohet plotesimeve qe do te beje ortaku i vetem i shoqerise si dhe ligjeve te vecanta te ligjeslacionit shqiptar.

Ndryshimet e plotesimet e ketij statuti behen ne te njejtene menyre e procedure ne te cilen nxirret vete statuti.

Neni 18

Ky statut nxirret ne kater kopje dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise "BOROVAD"

Statuti miratohet nga ortaku i vetem themelues i cili e nenshkruan ate rregullisht dhe me vullnetin e tije te lire.

ORTAKU I VETEM

SAIMIR MALI

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E DREJTESISE  
ZYRA E NOTERISE DURRES

Nr 1 Rep  
Nr 2 Kol

VERTETIM

Sot me daten 11/11/1996 (nentedhjet e gjashte) u paraqit personalisht Z. Saimir Mali, me gjineralitet e sipershenuara, per iuidentitetin e te cilit e verifikova nepermjet leternjoftimit te tij personal, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili deklaroi se ka redaktuar jasht kesaj zyre kete statut, me vullnetin e tij te lire, ai e nenshkruan rregullisht para meje dhe une Noteri e vertetoj sipas ligjit.

NOTE RI

H. SALIH T. TIVARI

